



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

DREJTORIA E STREHIMIT SOCIAL DHE MENAXHIMIT TË BANESAVE SOCIALE

Datë, __. __. 2023

RELACION

PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 10 DATË 25.01.2023

“ MBI MIRATIMIN E SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR FAMILJET E PASTREHA ”

Në mbështetje të Ligjit nr.22/2018, “Për Strehimin Social”, të neneve 3, 16, 33, 34 dhe 38 të këtij ligji, “VKM 384, datë 12.06.2019, “Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për tu strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve, procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”, në VKM 362, datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij ” VKM nr.301, datë 15.04.2020 ”Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”, Ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, Ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore”, VKB nr. 183 datë 28.12.2022 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor 2023 të Bashkisë Korçë”, është miratuar V.K.B. nr.10, datë 25.01.2023 “ Mbi miratimin e subvencionit të qirasë për familjet e pastreha “, me listën emërore të aplikantëve për përfitimin nga programi i Subvencionit të Qirasë.

Subvencioni i qirasë është një instrument i programit të banesave sociale me qira,që ndihmon individët/familjet, të cilët me të ardhurat e tyre nuk përballojnë pagesën e qirasë sociale ose të qirasë reale në tregun e lirë.Masa e subvencionit përlllogaritet në varësi të të ardhurave të familjes. Ky program i dedikohet kryesisht familjeve me të ardhura te uleta/shume te ulëta ose pa të ardhura.

Nga rifreskimi i dokumentacionit dhe për ndonjë gabim material në llogaritjen e qirasë së përballueshme sipas aftësisë paguese bazuar ne niveli i të ardhurave, për disa nga familjet përfituese (me të ardhura të ulëta dhe shumë të ulëta) reflektohen ndryshime në masën e subvencionimit të qirasë.Për këtë arsye del i nevojshëm të bëhet ndryshimi si më poshtë vijon:

1-Jorgjeta Kostaq Polena

Të ardhurat ishin 24.670 lekë në muaj,aktualisht janë 26.022 lekë në muaj.

Aftësia përballuese e qirasë ishte 20% , bëhet 15%.

Qiraja e përballueshme ishte 4.934 lekë në muaj, bëhet 3.903 lekë në muaj.

Subvencioni ishte 2.066 lekë në muaj , bëhet 3.097 lekë në muaj.

Afatet e Kontrates ,nga 1.01.2023deri ne 31.12,2023 për 12 muaj.

2-Feim Shaban Kollonata

Të ardhurat ishin 30.000 lekë në muaj , aktualisht janë 30.192 lekë në muaj.

Aftësia përballuese e qirasë ishte 15% , mbetet 15%.

Qiraja që paguan familja ishte 12.000 lekë në muaj, bëhet 11.500 lekë në muaj.

Subvencioni ishte 10.200 lekë në muaj , bëhet 6.971 lekë në muaj.

Qiraja e përballueshme ishte 1.800 lekë në muaj, bëhet 4.529 lekë në muaj.

Afatet e kontratës 13.02.2023- 31.12.2023,për 10,5 muaj.

Këto ndryshime pasqyrohen në tabelën nr.1,që si rrjedhojë ndryshojnë shumën vjetore të subvencionit.

Shuma vjetore e subvencionit që mbulohet nga Bashkia Korçë ishte 727.407,36 lekë, bëhet 716,358 Lek.

Shuma vjetore e subvencionit që mbulohet nga Buxheti i Shtetit ishte 1.697.283,84 lekë, bëhet 1,671,500Lek.

Për arsyet e përmendura me lart, Drejtoria e Strehimit dhe MBS kabere korrigjimet dhe i paraqet Këshillit Bashkiak relacionin për ndryshimin e V.K.B. nr.10, datë 25.01.2023 “ Mbi miratimin e Subvencionit të Qirasë për familjet e pastreha “ .

Trajtimi nga ky program për këto familje do të jetë sipas afateve të vendosura në kontratën e Qiradhenies(akt noterial)për gjate vitit 2023.

Bashkëngjitur tabela nr.1,e me 22 familjet përfituese për vitin 2023.

M. Balli
Drejtore e Strehimit
Social dhe Menaxhimit
të Banesave Sociale .

V. Ziko
Drejtoria e Buxhetit
dhe MFK.

A.(Dishnica) Qeramixhi
Drejtore e Përgjithshme Juridike
dhe e Burimeve Njerëzore

KRYETARI I BASHKISË
Sotiraq Filo



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, datë _____ 2023

PËR

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 10 DATË 25.01.2023
“ MBI MIRATIMIN E SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR FAMILJET E
PASTREHA ”**

Në mbështetje të Ligjit nr.22/2018, “Për Strehimin Social”, të neneve, 3, 16, 33, 34 dhe 38 të këtij ligji, “VKM 384, datë 12.06.2019, “Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për tu strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve, procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”, në VKM 362, datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij” VKM nr.301, datë 15.04.2020 “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”, Ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, Ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore”, VKB nr.183, datë 28.12.2022 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor 2023 të Bashkisë Korçë”, është miratuar VKB. Nr.10 datë 25.01.2023 “Miratimin e subvencionit të qirasë për familjet e pastreha” me listën emërore të aplikantëve për përfitimin nga programet sociale të strehimit.

Propozohen për miratim ndryshimet në listën emërore të familjeve aplikante për përfitimin nga programi i Subvencionit të Qirasë (Bonusi i Strehimit).

Këshilli i Bashkisë Korçë në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi analizoi dhe shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave Sociale,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin në vendimin nr. 10, datë 25.01.2023 “ Mbi miratimin e subvencionimit të qirasë për familjet e pastreha “, sipas tabelës bashkëngjitur.
2. Subvencionimi i Qirasë për këto 22 familje do të jepet sipas afateve të vendosura në Kontratën e Qiradhënies (Akt- noterial) për vitin 2023.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe MFK.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10-ditë pas shpalljes.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK
Erjon Nexhipi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

VENDIM

Nr. _____, datë _____ 2023

MBI MIRATIMIN E SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR FAMILJET E PASTREHA

Në mbështetje të Ligjit nr.22/2018, “Për Strehimin Social”, të neneve, 3, 16, 33, 34 dhe 38 të këtij ligji, “VKM 384, datë 12.06.2019, “Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për tu strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve, procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”, në VKM 362, datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij” VKM nr.301, datë 15.04.2020 “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”, Ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, Ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore”, VKB nr.183, datë 28.12.2022 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor 2023 të Bashkisë Korçë”, është miratuar V.K.B. nr 10.

Propozohen për miratim ndryshimet në listën emërore të familjeve aplikante për përfitimin nga programi i Subvencionit të Qirasë (Bonusi i Strehimit).

Këshilli i Bashkisë Korçë në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi analizoi dhe shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave Sociale,

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin në vendimin nr. 10, datë 25.01.2023 “ Mbi miratimin e subvencionimit të qirasë për familjet e pastreha “, sipas tabelës bashkëngjitur.
2. Subvencionimi i Qirasë për këto 22 familje do të jepet sipas afateve të vendosura në Kontratën e Qiradhënies (Akt- noterial) për vitin 2023.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe MFK.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10-ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva NAÇI

K R Y E T A R

Erjon NEXHIPI

Miratuar me _____ vota
Vota Pro _____
Vota Kundër _____
Vota Abstenim _____
Zbardhur më datë _____

